

"TREMA ENGINEERING 2", Sh.p.k

**Pasqyrat Financiare Te Konsoliduara
per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013**

PERMBAJTJA

PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE E KONSOLIDUAR	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR E KONSOLIDUAR	2
PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE E KONSOLIDUAR	3
PASQYRA E LEVIZJES SE KAPITALEVE	4
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	5
1. Të dhëna të përgjithshme mbi Shoqërinë.....	5
2. Politika të Rendesishme Kontabel.....	5
3. Permbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabël	9
4. Te ardhurat	18
5. Mallrat, Lendet e para dhe shërbimet	20
6. Shpenzimet të tjera të veprimtarisë së shfrytëzimit.....	20
7. Shpenzimet e personelit	21
8. Shpenzimet e amortizimit.....	21
9. Te ardhura dhe shpenzime financiare	21
10. Fitim / (Humbje) e vitit ushtimor	22
11. Aktivet Afatgjata Materiale.....	24
12. Aktivet Afat Gjata Jo Materiale, AAJM.....	25
13. Kërkesa të arketueshme afatgjata	25
14. Kërkesa të arketueshme dhe të arketueshme të tjera	26
15. Inventari	26
16. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	27
17. Mjetet Monetare	27
18. Kapitali Aksionar	28
19. Huatë dhe interesat bankare	28
20. Provizionet	29
21. Të pagueshme ndaj furnitorëve	30
22. Detyrime ndaj Personelit	30
23. Detyrime tatimore	31
24. Te ardhurat e shtyra.....	31
25. Llogari të tjera të pagueshme	31
26. Transaksionet me paletë e lidhura.....	32
27. Instrumentat Financiare Manaxhimi i Riskut Financiar.....	33

TREMA ENGINEERING 2 SHPK**PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE E KONSOLIDUAR**

Per periudhen Janar- Dhejtor 2013

Pershkrimi	Shenime	31.12.2013	31.12.2012
Shitje neto	4	1,543,264,447	1,001,122,451
Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	4	22,350,679	43,152,327
Mallra, lendet e para dhe sherbimet	5	-1,066,145,726	-766,589,063
Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	6	-165,211,312	-68,797,064
Shpenzimet e personelit	7	-192,641,539	-197,167,234
Pagat		-171,107,638	-174,844,300
Shpenzimet e sigurimeve shoqerore		-21,533,901	-22,322,934
Amortizimi dhe Zhvleresimet	8	-57,669,310	-66,096,540
Fitimi (humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit		83,947,238	-54,375,123
Te ardhura dhe shpenzime financiare			
Te ardhura dhe shpenzime financiare nga interesi		-25,579,144	-30,896,299
Fitimi dhe humbje nga kursi i kembimit		-3,868,132	-2,702,392
Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare	9	-29,447,276	-33,598,691
Fitimi (humbja) para tatimit		54,499,962	-87,973,814
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin			
Fitim (humbje) neto e vitit financiar	10	54,499,962	-87,973,814

Shenimet Shpjeguese jane pjese integrale e pasqyrave financiare te shoqerise

TREMA ENGINEERING 2 SHPK**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR E KONSOLIDUAR**

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

AKTIVET	Shenime	31.12.2013	31.12.2012
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	11	433,764,858	322,174,106
Aktive afatgjata jomateriale	12	1,081,545	1,494,653
Kerkesa te arketueshme	13	341,647,437	383,830,557
Totali i aktiveve afatgjata		776,493,840	707,499,316
Aktive afatshkurtera			
Kerkesa te arketueshme	14	996,358,798	845,926,666
Kerkesa te tjera te arketueshme	14	17,274,665	15,995,696
Inventari	15	59,229,578	217,948,516
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	16	40,131,826	42,850,523
Mjete monetare	17	245,636,835	59,365,794
Aktive totale afatshkurtera		1,358,631,702	1,182,087,195
TOTALI I AKTIVEVE		2,135,125,542	1,889,586,511

PASIVET DHE KAPITALI

Kapitali			
Kapitali aksioner	18	545,568,000	545,568,000
Rezerva te konvertimit te monedhes se huaj		38,236	22,829
Rezultati i mbartur		(96,550,154)	(8,576,340)
Rezultati i ushtrimit		54,499,962	(87,973,814)
Totali i kapitalit		503,556,044	449,040,675
Pasive afatgjata			
Huate	19	333,826,317	261,375,873
Provizione Afatgjata	20	67,649,991	63,248,300
Totali i pasiveve afatgjata		401,476,308	324,624,173
Pasive afatshkurtera			
Huate	19	238,251,361	398,027,881
Te pagueshme ndaj furnitoreve	21	671,544,904	590,177,911
Detyrime ndaj Personelit	22	22,255,957	8,876,503
Detyrime Tatimore	23	31,557,858	20,464,116
Te ardhurat e Shtyra	24	147,875,911	21,228,790
Te tjera llogari te pagueshme	25	61,487,753	74,638,632
Provizione afatshkurtra	20	57,119,446	2,507,830
Totali i pasiveve afatshkurtera		1,230,093,190	1,115,921,663
TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT		2,135,125,542	1,889,586,511

Shenimet Shpjeguese jane pjese integrale e pasqyrave financiare te shoqerise

TREMA ENGINEERING 2 SHPK**PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE E KONSOLIDUAR**

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

Pershkrimi	Ne leke 31.12.2013	Ne leke 31.12.2012
Fluksi monetar nga veprimtaria e shfrytezimit		
Fitimi para tatimit	54,499,962	(87,973,814)
Rregullime per:		
Shpenzime per interesa te njohura ne PASH	25,579,377	30,896,805
Provizione te tjera	(59,013,307)	(2,822,396)
Amortizimi i Aktiveve Afat gjate	57,669,310	65,837,814
Te ardhura (Humbje) nga kembimet valutore	3,868,132	2,702,392
Ndryshimet ne Flukset e MM nga aktiviteti i shfrytezimit	82,603,474	8,640,801
Rritje/renie e kerkesave te arketueshme	(151,711,101)	92,246,986
Rritje/renie e tepricave te inventarit	158,718,938	(38,098,806)
Rritje/renie ne shpenzimet e shtyra	2,718,697	(5,306,468)
Rritje/renie ne llogarite e furnitoreve	92,689,310	211,270,929
Rritje/renie ne parapagime te ardhura te shtyra	126,647,121	(96,053,459)
Interes i paguar	(12,136,439)	(30,896,805)
MM Neto nga aktivitetet e shfrytezimit	216,926,526	133,162,377
Fluksi monetar nga veprimtaria e investimit		
Interes i arketuar	232	506
Pagesa per blerje AAM	(100,581,914)	(7,880,551)
Arketime nga shitja e AAM	32,465,679	6,126,268
MM Neto nga aktiviteti i investimit	(68,116,003)	(1,753,777)
Fluksi monetar nga veprimtaria e financiare		
Rritje/renie ne llogarite e kerkesave per arketim afat gjate	42,183,120	6,020,580
Rritje/renie ne huamarrje afat gjate	(87,326,076)	(99,272,208)
MM Neto nga aktiviteti financiar	(45,142,956)	(93,251,628)
Diference konvertimi MM te mbajtura ne monedhe te huaj		
Rritja /renia neto e mjeteve monetare	186,271,041	46,797,773
Paraja dhe ekuivalenteve te saj ne fillim te vitit	59,365,794	12,568,021
Paraja dhe ekuivalenteve te saj ne fund te vitit	245,636,835	59,365,794

Shenimet Shpjeguese jane pjese integrale e pasqyrave financiare te shoqerise

TREMA ENGINEERING 2 SHPK

PASQYRA E LEVIZJES SE KAPITALEVE
Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

Kapitali aksionar që i përket aksionerëve të shoqërisë						
Pershkrimi	Kapitali aksionar	Rezerva Statutore e Ligjore	Rezerva te konvertimit		Fitimi I pashperndar e periudhes	Totali
			monedhave te huaja	te		
Pozicioni më 31 dhjetor 2011	545,568,000	141,623,847	91,118	11,270,257	-161,561,562	536,991,660
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabel						
Pozicioni i rregulluar	545,568,000	141,623,847	91,118	11,270,257	-161,561,562	536,991,660
Fitimi neto i vitit financiar						
Dividendët e paguar					-87,973,814	-87,973,814
Transferime në rezervën e detyrueshme statutore						
Transferime te tjera	-141,623,847	-	68,289	-19,846,597	161,561,562	22,829
Emetim i kapitalit aksionar						
Pozicioni më 31 dhjetor 2012	545,568,000	-	22,829	- 8,576,340	-87,973,814	449,040,676
Fitimi neto i vitit financiar					54,499,962	54,499,962
Dividendët e paguar						
Transferime në rezervën e detyrueshme statutore						
Transferime te tjera			15,407	-87,973,814	87,973,814	15,407
Emetim i kapitalit aksionar						
Pozicioni më 31 dhjetor 2013	545,568,000	-	38,236	- 96,550,154	54,499,962	503,556,044

Pasqyrat financiare te shoqërisë se bashku me shenimet shpjeguese janë aprovuar me 10 Mars 2014 nga drejtimi i shoqërisë:

Ilir Trebicka
Administrator Teknik

Frank Weimer
Administrator Tregtar

Dila Doda
Pergjegjese Finances

Shenimet Shpjeguese janë pjesë integrale e pasqyrave financiare te shoqërisë



Shenime mbi pasqyrat financiare
Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. Të dhëna të përgjithshme mbi Shoqërinë

“TREMA ENGINEERING 2”, sh.p.k është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar me vendim të Gjykatës së rrethit Tiranë me numer të regjistrimit tregtar 26524 datë 22.10.2001, në përputhje me ligjin “Për Shoqëritë Tregtare” dhe statuti i saj.

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është ndërtimi dhe projektimi i godinave me karakter civile e industriale, veprave të artit e infrastrukturës rrugore etj. Gjatë vitit 2013 shoqëria ka zbatuar dhe ka në proces disa kontrata, ndër të cilat mund të përmendim:

- Ndërtimin e objektit - Paraburgimi dhe Burgu Fier (kontratë në proces)
- Ndërtimi i Ujësjetës Bilisht
- Ndërtimi i Tunelit në Lengaricë
- Ndërtimi i rrugëve hyrëse në Moglicë
- Ndërtime të ndryshme për investitorë privat e shtetërorë

Administratorë të shoqërisë janë Z. Ilir TREBICKA në cilësinë e administratorit teknik dhe Z. Frank WEIMER në cilësinë e administratorit tregëtar.

Adresa e shoqërisë është Rr“Bardhok Biba”, Tiranë dhe është e regjistruar si person juridik në Njësinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj me NUIS K21401004R.

Pasqyrat financiare të shoqërisë për ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013 u miratuan nga Administratorët me 10 Mars 2014.

2. Politika të Rëndësishme Kontabel

Bazat e përgatitjes

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të vitit 2013, janë përgatitur në përputhje me Rregulloren Shqiptare të Kontabilitetit, që përfshijnë rregullat dhe interpretimet në përputhje me ligjin Nr 9228 datë 29 Prill 2004 “Mbi Kontabilitetin” dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të aprovuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK) me vendimin nr. 1 datë 19.04.08 dhe urdhër të Minsitrit të Financave nr. 65 data 5.05.2008 për publikimin dhe implementimin SNRF të aprovuara nga KKK.

Bazat e matjes

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të rasteve që përcaktohet ndryshe në shënimet në vijim.

Ndryshime në politikat kontabël dhe Metodat e Vlerësimit kontabël

Politikat kontabel te perdorura jane konsistente me politikat e perdorura ne vitin e meparshem me perjashtim te sa me poshte:

Ceshtja	Kerkesat Kryesore	Ndikimi ne PF
Data Efektive - 1 Korrik 2012		
Amendimi I SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" lidhur me te e pergjithshme	Ndryshimi kryesor qe rezulton nga ky amendim eshte nje kerkese ndaj shoqerive per te grupuar zera te paraqitura ne te ardhurat e tjera te pergjithshme, mbi bazen nese ato jane potencialisht te riklasifikueshme ne fitim ose humbje ne menyre pasuese (Axxhustime te Riklasifikimit). Ky ndryshim nuk adreson se cilat jane zerat qe paraqiten ne te ardhurat e tjera te pergjithshme.	Nuk kane efekt ne pergatitjen e pasqyrave financiare te shoqerise
Data Efektive- 1 Janar 2013		
Amendimi ne SNK 19, "Perfitimet e Punonjesve"	Keto amendime eliminojne perqasjen "korridor", dhe llogarisin kostot financiare mbi baza neto financimi.	Nuk kane efekt ne pergatitjen e pasqyrave financiare te shoqerise
Amendimi I SNRF 1, "Adoptimi per here te pare" mbi huatë qeveritare	Ky amendim adreson se si nje adoptues per here te pare do te gjykonte ne lidhje me nje hua qeveritare, me nje norme interesi poshte nivelit te tregut ne daten e kalimit ne SNRF. Ky amendim perjashton zbatimin ne ne menyre retrospektive (Prapavepruese) te SNRF, I cili I jep te njejten lehtesi qe ju dha pergatitesit ekzistues te pasqyrave financiare, kur kjo kerkese u inkorporua tek SNRF 20 ne vitin 2008, edhe adoptuesit per here te pare te standardeve.	Nuk kane efekt ne pergatitjen e pasqyrave financiare te shoqerise
Amendimi I SNRF 7- "Instrumentat financiare" – dhenia e informacioneve shpjeguese ne lidhje me kompesimin e aktiveve dhe detyrimeve	Ky ndryshim parashikon dhenien e informacioneve shpjeguese shtese per te lehtesuar krahasimin ndermjet shoqerive te cilat pergatisin pasqyra financiare ne perputhje me SNRF dhe atyre qe perqatisin pasqyra financiare ne perputhje me PPPK the SHBA.	Nuk kane efekt ne pergatitjen e pasqyrave financiare te shoqerise
Amendime te SNRF-ve 10,11,12 - udhezime ne daten e kalimit ne SNRF	Keto ndryshime sigurojne nje lehtesim shtese per daten e zbatimit fillestar, duke e kufizuar kerkesen per dhenien e informacionit krahasues te axhustuar vetem ne periudhen krahasuese paraardhese. Per sa I perket shenies se informacionit shpjegues per shoqerite me struktura te pakonsoliduara, ndryshimet do te eliminojne kerkesat per te paraqitur informacion krahasues per periudhat perpara se SNRF -12 te aplikohet per here te pare.	Nuk kane efekt ne pergatitjen e pasqyrave financiare te shoqerise

TREMA ENGINEERING 2 Sh.p.k

Shenime mbi pasqyrat financiare

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

Permiresimet Vjetore 2011	Keto permiresime vjetore adresojne gjashte ceshtje ne ciklin e raportimit 2009-2011. Kjo perfshin ndryshime ne: - SNRF 1 – “Adoptimi per here te pare” - SNK 1 – “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” - SNK 16 – “Aktivet Afatgjata Materiale” - SNK 32 – “Instrumentat Financiare- Paraqitja” - SNK 34- “Raportimi Financiar I Ndermjetem”	Nuk kane efekt ne pergatitjen e pasqyrave financiare te shoqerise
SNRF 10, “Pasqyrat Financiare te Konsoliduara”	Objektivi I SNRF – 10 eshte te vendose parimet per paraqitjen dhe pergatitjen e pasqyrave financiare te konsoliduara kur nje njesi shoqeri kontrollon nje apo me shume shoqeri te tjera, per te paraqitur pasqyra financiare te konsoliduara. Ky standard percakton parimin e kontrollit, dhe vendos kontrollin si baze per konsolidimin. Gjithashtu ky standard percakton se si te aplikohet parimi i kontrollit per te identifikuar nese nje njesi ekonomike investitore kontrollon njesine ekonomikene te cilen eshte bere investimi, dhe per rrjedhoje duhet te konsolidoje njesine ekonomike ne te cilen eshte bere investimi. Ky sandard percakton kerkesat kontabel per pergatitjen e pasqyrave financiare te konsoliduara.	Nuk kane efekt ne pergatitjen e pasqyrave financiare te shoqerise
SNRF 11- Marreveshjet e Perbashketa	SNRF 11 eshte nje pasqyrim me real I marreveshjeve te perbashketa duke u fokusuar ne te drejtat dhe detyrimet e marreveshjes dhe jo ne formen e saj ligjore. Ekzistojne dy lloje te marreveshjeve te perbashketa: operacionet e perbashketa dhe sipermarrjet e perbashketa. Operacionet e perbashketa lindin kur nje operator i perbashket ka te drejta mbi aktivin dhe detyrime lidhur me marreveshjen dhe per kete arsye konsideron interesat e tij ne aktivet, detyrimet, te ardhurat dhe shpenzimet. Sipermarrjet e perbashketa lindin kur operatori i perbashket ka te drejta ne aktivet neto te marreveshjes dhe per rrjedhoje llogarit interesat e tij ne lidhje me kapitalin. Konsolidimi proporcional i sipermarrjeve te perbashketa nuk eshte i lejuar.	Nuk kane efekt ne pergatitjen e pasqyrave financiare te shoqerise
SNRF 12 – dhenia e informacionit shpejgues per interest ne shoqerite e tjera	SNRF 12 perfshin kerkesat per dhenien e informacioneve shpjeguese per sa I perket te gjitha formave te interesave ne shoqerite e tjera, perfshire marreveshjet e perbashketa, pjesmarrjet, automjetet per qellimet te vecanta dhe te tjera automjete jashte bilancit.	Nuk kane efekt ne pergatitjen e pasqyrave financiare te shoqerise

TREMA ENGINEERING 2 Sh.p.k

Shenime mbi pasqyrat financiare

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

SNRF 13, "Matja e vleres se drejte"	SNRF 13 ka per qellim te permiresoje qendrueshmerine dhe te reduktoj kompleksitetin duke percaktuar nje perkufizim te sakte te vleres se drejte dhe duke siguruar nje burim te vetem per matjen e vleres se drejte si dhe shenimet shpjeguese per perdorim ne te gjitha SNRF-te. Kerketat te cilat shtrihen gjeresisht ndermjet SNRF dhe PPPK te SHBA, nuk zgjerojne predorimin e kontabilitetit te vleres se drejte, por japin udhezime se si duhet te zbatohet kur perdorimi i tij eshte i kerkuar ose i lejuar nga standarde te tjera brenda SNRF ose PPPK te SHBA.	Nuk kane efekt ne pergatitjen e pasqyrave financiare te shoqerise
SNK 27 (Rishikuar ne 2011), "Pasqyra financiare individuale"	SNK 27 (rishikuar ne 2011) perfshin dispozitat mbi pasqyrat financiare te vecanta te cilat mbeten pasi jane perfshire ne SNRF 10 dhe dispozitat e kontrollit te SNK 27	Nuk kane efekt ne pergatitjen e pasqyrave financiare te shoqerise
SNK 28 (rishikuar ne 2011), "Pjesemarrjet dhe siperemarrjet e perbashketa"	SNK 28 (rishikuar ne 2011) perfshin kerketat per siperemarrjet e perbashketa, si dhe pjesemarrjet, te cilat llogariten ne kapital ne vijim te SNRF 11	Nuk kane efekt ne pergatitjen e pasqyrave financiare te shoqerise
KIRFN 20, "Kostot e nxjerrjes ne fazen e prodhimit te nje minere ne siperfaqe"	Ky interpretim percakton kontabilitetin per kostot e pastrimit (largimit) te mbetjeve ne fazen e prodhimit ne miniera	Nuk kane efekt ne pergatitjen e pasqyrave financiare te shoqerise

Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (BSNK) Standarded dhe Interpretimet e leshuara por ende te pa adoptuara

Standardet dhe interpretimet e BSNK qe jane leshuar por nuk jane ende te detyrueshme per zbatim, nuk jane adoptuar nga shoqeria dhe nuk pritet te kene nje ndikim material ne pasqyrat financiare te saj.

Qëllimi i konsolidimit dhe Metoda e Konsolidimit

Pasqyrat Financiare të konsoliduara të 31 Dhjetor 2013, përfshijnë përveç Trema Engineering 2, shpk - Shqipëri dhe Trema Engineering 2, sh.p.k - Kosovë, shoqëri e cila zotërohet 100% nga Trema Engineering 2, sh.p.k - Shqipëri.

Pasqyrat financiare te Trema Engineering 2, sh.p.k - Kosove janë të paaudituar.

Metoda e konsolidimit të përdorur është ajo e metodës së kostos. Metoda e kostos është një metodë e kontabilitetit për një investim, sipas të cilës investimi njihet me kosto. Shoqëria do të njohë të ardhura nga investimi vetëm në shkallën që ajo merr shpërndarje nga përfitimet e akumuluar të investimit pas datës së blerjes. Shpërndarjet e marra përtej këtyre përfitimeve konsiderohen si mbulim i investimit dhe do të njihen si zbritje të kostos për investim.

Shenimet Shpjeguese jane pjese integrale e pasqyrave financiare te shoqerise

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara, shoqëria kombinon pasqyrat financiare të shoqërisë mëmë dhe të filialeve të saj rresht për rresht duke mbledhur zëra të ngjashëm të aktiveve, pasiveve, kapitalit neto, të ardhurave dhe shpenzimeve. Në mënyrë që pasqyrat financiare të konsoliduara të paraqesin informacion aktual financiar rreth shoqërisë mëmë si një njësi e vetme ekonomike vlera kontabël neto e investimit të shoqërisë mëmë në secilin filial dhe pjesa e kapitalit neto të shoqërisë mëmë për secilin filial eliminohet. Tepricat dhe transaksionet, duke përfshirë të ardhurat, shpenzimet dhe dividendët brënda grupit eliminohen plotësisht.

Pasqyrat Financiare të shoqërisë mëmë dhe filialit të saj, të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, janë përgatitur në të njëjtën datë raportimi. Pasqyrat Financiare të konsoliduara janë përgatitur duke përdorur politika kontabël uniforme për transaksione dhe ngjarje të tjera të njëjta në rrethana të ngjashme.

a. Monedha Funksionale dhe me të cilën paraqiten pasqyrat

Pasqyrat Financiare paraqiten në monedhën vendase Lek (ALL), e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë. Informacioni në pasqyrat financiare është paraqitur në Lekë, ndërsa në shënimet e pasqyrave financiare është në mijë lekë, me përjashtim të rasteve që përcaktohet ndryshe në shënimet në vijim.

b. Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrorë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në vecanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

Disa prej të dhënave të informacionit financiar krahasues janë rikalsifikuar në përshtatje me kërkesat e raportimit financiar.

3. Përmbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabël

Politikat kryesore kontabël të zbatuara nga shoqëria janë të përshkruara në vijim:

a. Veprimet në monedha të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në kontabilitet me kursin e datës së kryerjes së transaksionit.

TREMA ENGINEERING 2 Sh.p.k

Shenime mbi pasqyrat financiare

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj janë përkthyer në pasqyrën e bilancit me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë me 31.12.2013. Diferencat nga kursi i këmbimit të lindura nga përkthimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Asetet dhe detyrimet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Asetet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj që paraqiten me vlerën e drejtë përkthehen me kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është përcaktuar.

Kursi i këmbimit për dy monedhat e huaja kryesore me monedhën vendase sipas kursit të Bankës së Shqipërisë me 31.12.2013, ka qenë respektivisht si më poshtë:

<u>Monedha</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>	<u>31 Dhjetor 2012</u>
1 EUR	140.20	139.59
1 USD	101.86	105.85

b. Instrumenta financiar

Instrumentat financiarë jo-derivativë të shoqërisë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, likuiditete dhe vlera arke të tjera, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

i. Njohja fillestare dhe cregjistrimi

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit në fjalë. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë perfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

ii. Njohja e mëtejshme

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë tepricat e arkës, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat dhe ato me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare. Likuiditetet dhe vlera arke të tjera maten më tej me koston e amortizuar pakësuar me humbjet nga zhvlerësimet.

Huatë dhe Llogari të arkëtueshme

Huatë e dhëna dhe Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Llogaritë e arkëtueshme afatshkurtra nuk skontojnë.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv nëse është materiale.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv. Kostot e huadhenies kapitalizohen si pjesë e koston së një aktivi që kërkon domosdoshmërisht një periudhë të rëndësishme për t'u përgatitur për përdorimin e destinuar apo shitjen e tij. Fitimet dhe humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivet dhe detyrimet financiare të mësipërme zhvlerësohen sikurse dhe nëpërmjet procesit të amortizimit.

iii. Zhvlerësime të aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet si i zhvlerësuar në ato raste kur ekzistojnë kushte objektive që tregojnë se një apo me shumë ngjarje (pas njohjes së tij fillestare) kanë efekte negative në flukset e ardhshme të parasë që parashikohet të burojnë prej atij aktivi. Vështirësitë e konsiderueshme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do të falimentojë apo një riorganizim financiar, dhe pamundësia apo shkeljet në pagesa konsiderohen si tregues që një llogari e arkëtueshme është e zhvlerësuar.

Aktivitet e rëndësishme financiare testohen në mënyrë individuale për zhvlerësim. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, mbi bazë grupesh që kanë karakteristika të ngjashme të riskut financiar.

Humbja nga zhvlerësimi lidhur me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferenca midis vlerës kontabel të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit të aktivitetit. Vlera e një aktivi zvogëlohet nëpërmjet llogarisë për zhvlerësime dhe vlera e humbjes nga zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Të ardhurat nga interesi vazhdojnë të rriten mbi vlerën kontabel të aktualizuar, bazuar në normën origjinale efektive të aktivitetit. Llogaritë e arkëtueshme së bashku me fondin rezervë të zhvlerësimit që i shoqëron c'regjistrohen atëherë kur nuk ka shpresa për rikuperim real në të ardhmen.

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Nëse në një vit pasues, shuma e humbjeve të vlerësuar nga zhvlerësimi rritet apo ulet për shkak të një ngjarje pas njohjes fillestare të aktivitetit, humbja nga zhvlerësimi i njohur më parë rritet apo reduktohet duke rregulluar llogarinë e fondit rezervë të zhvlerësimeve. Nëse një aktiv i cregjistruar më parë, rikuperohet, ky rikuperim njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

iv. Zhvlerësimi i Aktivitet jo-financiare

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

v. Netimi i Instrumentave financiare

Aktivitet dhe pasivitet financiar netohen dhe shuma neto e tyre raportohet në bilanc nëse, dhe vetëm nëse ka një të drejtë të detyrueshme ligjore për të netuar shumën e njohur dhe ekziston mundësia për të shlyer në shumën neto, apo për të realizuar aktivin dhe shlyer pasivitet njëkohësisht. Kjo vlen kryesisht për balancat ndaj/dhe nga operatorët e tjerë të telekomunikacioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat shlyhen në shumën neto, në përputhje me kontratat ekzistuese.

vi. Përcaktimi i Vlerës së Drejtë

Vlera e drejtë e parasë dhe e likuiditeteve, llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme janë afërsisht të barabarta me vlerën kontabel të dhënë, për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

vii. Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

viii. Kapitali aksioner

Kapitali aksioner njihet me vlerën nominale.

a. Inventari

Inventari i imët është përfshirë në këtë grup sipas rregullave kontabile në Shqipëri.

Inventari paraqiten me vlerën më të ulët mes kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i përlogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit, pa koston e përlogaritur të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes. Kostot e inventarit janë përlogaritur duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e kryera gjatë blerjes së inventarit dhe dërgimit të tyre në kushtet dhe vendodhjen ekzistuese.

b. Investime në pjesëmarrje

Investimet në pjesëmarrje fillimisht njihen me kosto. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e pjesëmarrjes në fjalë.

c. Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)

i. Njohja dhe matja

Zërat e llogarisë toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje janë të paraqitura me vlerën e drejtë duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Të gjitha aktivet e tjera afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendodhjes së aktivit.

Kostoja e aktiveve të kualifikuara përfshin kostot e interesit të kryera gjatë periudhave të ndërtimit, nëse ka, bazuar në normën mesatare të matur të huadhënies.

Software i blerë që është thelbësor për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj pajisje.

Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afat-gjate materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afat-gjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afat-gjate material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Amortizimi kalohet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve. Normat vjetore të amortizimit të përdorura, bazuar në Ligjin 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave No.5 datë 30.01.2006 janë si më poshtë:

Aktivet e qëndrueshme të trapezuara	Norma e amortizimit %		Metoda e llogaritjes
	2013	2012	
Ndertesa dhe instalime	5	5	Vlerën e Mbetur
Makineri e pajisje	20	20	
Instalimet	20	20	
Mjete transporti	20	20	
Mobilje orendi	20	20	
Pajisje elektronike	25	25	

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proces që nuk janë në funksionim.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të ushtrimit.

d. Aktivët afatgjatë Jomateriale

Aktivët afatgjatë jomateriale përfshijnë licencat, të drejtat për përdorim dhe emri i mirë.

i. Njohja dhe Matja

Licencat, të drejtat e përdorimit të cilat përfitohen nga shoqëria si edhe emri i mirë paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shihni me poshtë) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

ii. Shpenzimet pasuese

Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje në momentin kur kryhen.

iii. Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve të patrupëzuara që nga data që janë të disponueshme për përdorim. Jetëgjatësia e parashikuar e aktiveve për periudhat aktuale dhe krahasuese është si më poshtë:

Liçensat dhe të drejtat e përdorimit

7 vjet

iv. Zhvlerësimi (Rënia në vlerë)

